



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIATEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 579/2 prot.

Tepelenë, më 31.03.2026

V E N D I M

Nr. 24, datë 30.03.2026

“PËR MIRATIM TË MARRËVESHJES TIP ME KËSHILLIN E QARKUT GJIROKASTËR”

Në mbështetje të nenit 54, shkronjat “k”, nenit 31/2 dhe 22/3, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, si edhe në vijim të relacionit të grupit të punës nr. 579/ prot, datë 24.03.2026,

V E N D O S I:

1. Miratim të marrëveshjes tip me Këshillin e Qarkut Gjirokastër, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me ndryshimin e neneit 4 “Dispozita të përgjithshme” si më poshtë;
“Ky akt-marrëveshje mund të ndryshohet ose përmirësohet në çdo kohë, me vullnetin e lirë të palëve, me miratimin e Këshillit Bashkiak.”
2. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Bashkia Tepelenë të ndjek procedurën sipas parashikimeve të këtij vendimi, si dhe nxjerrjen e çdo akti të nevojshëm për zbatimin e tij.
4. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e ligjore dhe shërbimeve Organizative, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Sportit dhe Kujdesit Shoqëror, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.



Sekretari Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë) vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 31.03.2026

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr 881/ Prot, datë 8/12 /2025



KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr _____ Prot, datë ___/___/2026

AKT-MARRËVESHJE

Sot më datë 8.12.2025 duke u mbështetur në vullnetin e lirë të palëve,

1. Këshilli i Qarkut Gjirokaster i përfaqësuar nga Kryetari Z.Dino Selmi.
2. Këshilli Bashkiak Tepelone përfaqësuar nga Kryetari Z/Znj. _____

Mbeshtetur ne Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", përkatësisht Neni 31/2 dhe 22/3 i tij, kane rënë dakord për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

NENI 1

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Objekti i kësaj akt marrëveshje është delegimi i funksioneve të mëposhtme:

- në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- në fushën e shërbimeve sociale
- në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese
- në fushën e mbrojtjes së mjedisit

me qëllim realizimin e objektivave të vendosura në buxhetin e vitit 2026 për Këshillin e Qarkut Gjirokastër.



NENI 2

KOHËZGJATJA DHE EFEKTET JURIDIKE

Palët bien dakort se efektet juridike të kësaj akt marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj e do të zgjasin deri në 31.12.2026.

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

3.1 Këshilli i Qarkut merr përsipër realizimin e objektivave të vendosura në buxhetin e vitit 2026 që kanë lidhje direkte me funksionet e deleguara në nenin 1.

Këshilli i Qarkut merr përsipër sigurimin e fondeve për realizimin e projekteve funksion i kësaj akt -marrëveshjeje

3.2 Këshilli i Qarkut do të informojë Bashkinë Tepelenë rast pas rasti lidhur me ecurinë e raalizimit të projekteve.

3.3 Bashkia Tepelenë ushtron kompetencën dhe vendos për nivelin e kuotës së anëtarësisë të detyrueshme për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut.

3.4 Këshilli i Qarkut dhe Bashkia Tepelenë përmes kësaj akt-marrëveshjeje autorizojnë respektivisht Kryetarin e Këshillit të Qarkut dhe Kryetarin e Bashkisë për lidhjen e akt-marrëveshjeve për projektet specifike rast pas rasti.

NENI 4

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Kjo akt-marrëveshje mund të përmirsohet në çdo kohë me vullnetin e lirë të palëve.

Kjo akt-marrëveshje miratohet nga palët dhe nënshkruhet me pëlqimin e plotë të tyre në tre (3) kopje origjinale.

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	Këshilli Bashkiak Tepelenë
Dino Selimi	
Kryetar	Kryetar
	

